

17255

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 14299, i Vendimit

V E N D I M

MBI REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK
TE SHOQERISE TREGETARE "TERMO MONT" SH.P.K.

Sot me date 06 Maj 1997, une *M. Jeli*, gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane, morra ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesit Spartak Haxhiu dhe Nazmi Cako, me ane te se ciles kerkojne regjistrimin si person juridik te Shoqerise Tregetare "TERMO MONT" SH.P.K. dhe

K O N S T A T O V A :

Kerkuesit Spartak Haxhiu dhe Nazmi Cako kane bere kerkese prane kesaj Gjykate, me anen e se ciles kerkojne regjistrimin si person juridik te Shoqerise Tregetare "TERMO MONT" SH.P.K., per te ushtruar aktivitet tregetar me objekt :

Ndertime civile industriale, turistike, bujqesore, etj., si dhe kompletimi me instalimet e nevojeshme per to (punimet e montimit).

Montimi i impianteve teknologjike dhe te vecanta :

- impiante termike, te ventilimit, kondicionere, si dhe riparimi e mirembajtja e tyre
- impiante higjenosanitare, hidrosanitare, te gazit, si dhe riparimi e mirembajtja e tyre
- impiante ashensoresh, shkalle levizese, transportiere, etj., si dhe riparimi e mirembajtja e tyre

Punime hidraulike :

- ujesjellesa, kanalizime, impiante vaditese, etj.
- gazsjellesa, vajsjellesa, etj., te ketij karakteri
- impiante te pastrimit te ujit

Instalimi i impianteve dhe makinerive ngritese transportuese, si vinga, teleferike, etj. te ketij karakteri.

Import-eksporti e tregetimi i pajisjeve, makinerive, pjeseve te kembimit materialeve te ndertimit e te llojeve te ndryshme.

Kerkesa e tyre eshte e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet te pranohet.

P E R K E T E A R E S Y E :

Duke u bazuar ne dokumentacionin e paraqitur, si dhe ne Ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" ,

V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses se kerkuesve Spartak Haxhiu dhe Nazmi Cako dhe regjistrimin si person juridik te Shoqerise Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar "TERMO MONT" SH.P.K. , per te ushtruar aktivitetet tregetar me objekt:

Ndertime civile industriale, turistike, bujqesore, etj., si dhe kompleksi me instalimet e nevojeshme per to (punimet e montimit).

Montimi i impianteve teknologjike dhe te vecanta :

- impiante termike, te ventilimit, kondicionere, si dhe riparimi e mirembajtja e tyre
- impiante higjienosanitare, hidrosanitare, te gazit, si dhe riparimi e mirembajtja e tyre
- impiante ashensoresh, shkalle levizese, transportiere, etj., si dhe riparimi e mirembajtja e tyre

Punime hidraulike :

- ujesjellesa, kanalizime, impiante vaditese, etj.
- gazsjellesa, vajsjellesa, etj., te ketij karakteri
- impiante te pastrimit te ujit

Instalimi i impianteve dhe makinerive ngritese transportuese, si vinca, teleferike, etj. te ketij karakteri.

Import-eksporti e tregetimi i pajisjeve, makinerive, pjeseve te kombimit, materialeve te ndertimit e te llojeve te ndryshme.

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100 000 Leke (njqindmije).

Selija juridike e Shoqerise ndodhet ne adresen : Rr.'Ali Baushi', Pall.7, Shk.1, Ap.8, Tirane.

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore mbi 10 vjet.

Administratore te Shoqerise jane : z.Spartak Haxhiu dhe z.Nazmi Cako.

Kunder Vendimit mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit.

G J Y Q T A R E

Majane Veda
Majane Veda

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR. 17299/Vendimit

1648

V E N D I M

I GJYQTARES SE VETME

Sot me date 22-01-2001 une Gjyqtaria e Gjykates se Rrethit Tirane M. Dear, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Spartak Haxhi dhe Nazmi Cako Administrator te shoqerise "TERMO MONT" shpk i cili kerkon depozitim ne Rregjistrin Tregetar e Vendimit te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise.

K O N S T A T O V A :

Me Vendimin Nr.17299 date 26.05.1997 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte rregjistruar si person juridik Shoqeria "TERMO MONT" shpk shoqeri kjo me dy ortak Spartak Haxhi dhe Nazmi Cako dhe te dy Administrator, me Seli ne Tirane, me kapital 100.000 leke , i ndare ky kapital 51% Spartak haxhi dhe 49% Nazmi Cako.

Me vendim NR.1 date 13.10.2000 Asambleja e Ortakeve te Shoqerise "TERMO MONT" shpk ka vendosur:

1. Shitjen e pjeseve te kuotave te kapitalit themeltar te ortakëve Spartak Haxhi ne masen 10% dhe Nazmi Cako ne masen 10%, Z. Mark Kaçaj.
2. Pranimin si ortak ne kete shoqeri Z.Mark Kaçaj me kuote 20% te kuotave te Kapitalit themeltar.
3. Ndrimi i selise se shoqerise "TERMO MONT" shpk nga Adresa Rruga "Ali Baushi" P.7 shk.1 ap.3 ne kete Adrese Rruga "Qemal Stafa" nr.260/1.

Kerkesa, qe keto ndryshime te reflektohen ne skeden perkatese te kesaj shoqerie eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar

PER KETO ARESYE

Ne baze te ligjit Nr.7667 Date 28.01.1993 Per Rregjistrin Tregetar e formalitet qe duhen plotesuar ne te.

VENDOSA:

Pranimin e kerkeses se Spartak Haxhi dhe Nazmi Cako Administratore te shoqerise "TERMO MONT" shpk per depozitimin e Vendimit te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise Nr.1 date 13.10.2000 ku eshte vendosur:

1. Shitja e pjeseve te te kuotave te kapitalit themeltar te ortakeve Spartak haxhi ne masen 10% dhe Nazmi Cako ne masen 10% Z. Mark Kaçaj.

2. Pranimin si ortak ne kete shoqeri Z.Mark Kaçaj me kuote 20% te kuotave te Kapitalit themeltar.

3. Ndrimi i selise se shoqerise nga Adresa Rruga "Ali Baushi" P.7 shk.1 ap.3 Tirane ne kete Adrese Rruga "Qemal Stafa" Nr.260/1.

Mbas ketyre ndryshimeve Shoqeria "TERMO MONT" shpk do te jete shoqeri me tre Ortake Spartak Haxhi, Nazmi Cako dhe Mark Kaçaj me kapital 100.000 leke i ndare ky kapital ne kete menyre:

| | |
|---------------------|-----|
| SPARTAK HAXHI _____ | 41% |
| NAZMI CAKO _____ | 39% |
| MARK KAÇAJ _____ | 20% |

Administrator te Shoqerise jane **Spartak Haxhi** dhe **Nazmi Cako**, me Seli ne Tirane Rruga "Qemal Stafa" NR. 260/1.

Urdherimin te behen ndryshimet perkatese ne skeden e kesaj shoqerie ne kolonen e dyte, germa b,d,c si dhe ne kolonat 4 e 5 me numer rendor 2 si dhe te ndahen rregjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE

Maniush Dedi
M. Dedi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR.19299/2

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 09.05.2005, une, gjyqtarja e Gjykeses se Shkalles se Pare Tirane, pasi shqyrtova kerkesen per depozitim ne regjistrin tregtar te vendimit nr.2 date 04.05.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise tregtare "TERMO MONT" sh.p.k. dhe dokumentave te tjera te paraqitura prej tij,

K O N S T A T O V A :

Me vendimin nr. 19299, dt. 26.05.1997 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare "TERMO MONT" sh.p.k me ortak Spartak Haxhi dhe Nazmi Cako dhe administrator te dy ortaket Spartak Haxhi dhe Nazmi Cako me seli ne Tirane.

Me vendimin nr.19299/1, date 22.01.2001 kjo shoqeri ka bere shtese ortaku ku futet z. Mark Kaçaj me 20 % kuota si dhe ka ndryshuar seline e shoqerise e cila tani ndodhet ne rrugen "Qemal Stafa", nr.260/1.Pra kjo shoqeri behet me tre ortake z. Spartak Haxhi, Nazmi Cako dhe Mark Kaçaj, me administrator Spartak Haxhi dhe Nazmi Cako

Me vendimin nr.2 te Asamblese se Ortakeve ta dates 04.05.2005 kjo shoqeri ka vendosur te caktoje si eksperte kontabel te autorizuar Violeta Haloci me license nr.83 te hartoje raportin per rritjen e kapitalit te nenshkruar te shoqerise .

Ne keto kushte kerkuesi kerkon depozitim e vendimit nr. 2, dt. 04.05.2005 te Asamblese se Ortakeve regjistrin tregtar.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

P E R K E T O A R S Y E :

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar"

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitim ne regjistrin tregtar te e vendimit nr.2, dt. 04.05.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise tregtare "TERMO MONT" sh.p.k eshte vendosur te miratoje aktin e ekspertimit te ekspertes kontabel te autorizuar znj. Violeta Haloci per te hartuar raportin per rritjen e kapitalit te nenshkruar te shoqerise .

Te behen ndryshimet perkatese duke u ndare regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE
BLERINA MUÇA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR.17299/3

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 16.05.2005, une, gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, pasi shqyrtova kerkesen per depozitim ne regjistrin tregtar te vendimit nr.3 date 16.05.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise tregtare "TERMO MONT" sh.p.k. dhe dokumentave te tjera te paraqitura prej tij,

K O N S T A T O V A :

Me vendimin nr. 17299, dt. 26.05.1997 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare "TERMO MONT" sh.p.k me ortak Spartak Haxhi dhe Nazmi Cako dhe administrator te dy ortaket Spartak Haxhi dhe Nazmi Cako me seli ne Tirane.

Me vendimin nr.17299/1, date 22.01.2001 kjo shoqeri ka bere shtese ortaku ku futet z. Mark Kaçaj me 20 % kuota si dhe ka ndryshuar seline e shoqerise e cila tani ndodhet ne rrugen "Qemal Stafa", nr.260/1.Pra kjo shoqeri behet me tre ortake z. Spartak Haxhi, Nazmi Cako dhe Mark Kaçaj, me administrator Spartak Haxhi dhe Nazmi Cako

Me vendimin nr.2 te Asamblese se Ortakeve ta dates 04.05.2005 kjo shoqeri ka vendosur te caktoje si eksperte kontabel te autorizuar Violeta Haloci me license nr.83 te hartoje raportin per rritjen e kapitalit te nenshkruar te shoqerise .

Me vendimin nr.3 te Asamblese se Ortakeve date 16.05.2005 eshte vendosur :

1. Te miratoje raportin e rritjes se kapitalit te nenshkruar te shoqerise "TERMO MONT" shpk te vleresuar nga ekspertja kontabel e autorizuar znj. Violeta Haloci , e cila nga 100.000 leke behet ne 29.711.000 leke.
2. Depozitimim e ketyre ndryshimeve ne regjistrin tregtar.

Ne keto kushte kerkuesi kerkon depozitimim e vendimit nr. 3, dt. 16.05.2005 te Asamblese se Ortakeve ne regjistrin tregtar.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE :

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar"

VENDOSA

Pranimin e kerkeses.

Depozitim in ne regjistrin tregtar te e vendimit nr.3, dt. 16.05.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise tregtare "TERMO MONT" sh.p.k ku eshte vendosur miratimi i raportit te rritjes se kapitalit te nenshkruar te shoqerise "TERMO MONT" shpk te vleresuar nga ekspertja kontabel e autorizuar znj. Violeta Haloci , e cila nga 100.000 leke behet ne 29.711.000 leke.

Te behen ndryshimet perkatese ne kollonen nr.2, germa "ç" duke u ndare regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE

BLERINA MUÇA



Uroshai registri mi

1
2
3
4
5

17299

2 9- "Termo - shod", Sept.

b. Ad: "Ali Bausli", p. 7, shk. 1, Ap 3, Gironi.

c. - Shkimbime civile, industriale, turistikë
 montime inxhinere, punime hidroelektrike
 instalime; inxhinere, punime
 input - eksport e tregëtimi; pajisje
 mbalje neurale, pajisje te komunikimit.

d. 100 000 lekë
 Spardak Haxhiu 51 000 lekë
 Nazmi Callo 49 000 lekë

3. Admi: 1 - Spardak Haxhiu dit 1952 Banues
 Adi: "A. Bausli", p. 7, shk. 1, Ap 3, Gironi.

2 - Nazmi Callo dit 1952 Banues Gironi

4. 10 vjet
 M. - 3 fletë
 K. - 6 fletë

5. 23 - 5 - 97
 26 - 5 - 97

[Signature]

- Certifikat. Shit. shtep Gironi L. dit 15-5-97
 - Rikene MT 0007. dit. 8-3-1993.

AKT THEMELIMI



PER KRIJIMIN E SHOQERISE TREGETARE ME
PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "TERMO MONT" SH.P.K

Themeluesit qe firmosin me poshte :

SPARTAK HAXHIU , i biri i Ksenofonit , i datelindjes 1952, lindur ne Gjirokaster, banues ne Tirane, Rr.Ali Baushi, Pall.7, Shk.1, Ap.3, me numur pasaporte 484731 ,

NAZMI CAKO , i biri i Qemalit, i datelindjes 1952, lindur ne Kolonje, banues ne Tirane, me numur pasaporte AZ 034208 ,

qe ne vijim do te quhen 'ortake' ,

vendosen qe sot me date 22.05.1997 , bazuar ne vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me Ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 'Per Shoqerite Tregetare', te themelojne nje Shoqeri Tregetare me Pergjegjesi te Kufi-zuar, me kushtet e meposhteme :

Neni 1

Ortaket vendosin qe Shoqerine ta emerojne :
"TERMO MONT" SH.P.K.

Neni 2

Shoqeria do te kete kete objekt veprimtarie :

Ndertime civile industriale, turistike, bujqesore, etj. dhe kompletimi me instalimet e nevojeshme per to (Punimet e montimit).

Montimi i impianteve teknologjike dhe te veçanta :

- impiante termike, te ventilimit, kondicionere, si dhe mirembajtja e riparimi i tyre
- impiante higjenosanitare, hidrosanitare, te gazit, si dhe mirembajtja e riparimi i tyre
- impiante ashensoresh, shkalle levizese, transportiere, etj., si dhe mirembajtja e riparimi i tyre

Punime hidraulike :

- ujesjellesa, kanalizime, impiante vaditese, etj.

- gazsjellësa, vajsjellësa, etj. të këtij karakteri
- impiante të pastrimit të ujit

Instalimi i impianteve dhe makinerive ngritëse e transportuese, si vinça, teleferike, etj. të këtij karakteri.

Import-eksporti e tregëtimit i pajisjeve, makinerive, pjesëve të këmbimit, materialeve të ndërtimit e të llojeve të ndryshme.

Neni 3

Shoqëria është person juridik. Veprimtaria e saj rregullohet me nenet e këtij Akti Themelimi, Statutit që është pjesë perberëse e tij, si dhe dispozitave ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregëtar nga Organet Kompetente dhe në përputhje me ligjin.

Neni 4

Selija juridike e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën :
Rruga 'Ali Baushi', Pall.7, Shk.1, Ap.3

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 000 Leke (njëqindmije). Ky kapital perbehet nga kontributet e mëposhteme :

| | |
|----------------|-------------|
| SPARTAK HAXHIU | 51 000 Leke |
| NAZMI CAKO | 49 000 Leke |

Neni 6

Fitimi neto i realizuar nga Shoqëria do të ndahet si vijon :

| | |
|----------------|------|
| SPARTAK HAXHIU | 51 % |
| NAZMI CAKO | 49 % |

Fitimi do të realizohet pasi të bëhet likuidimi i detyrimeve të Shoqërisë dhe pagimi i taksave e tatimeve sipas legjislacionit.

Neni 7

Shoqëria do të administrohet nga dy administratorë : z.SPARTAK HAXHIU dhe z.NAZMI CAKO. Ata kanë të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë për të kryer formalitetet e themelimit të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 8

Ortakët përballojnë humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontribu-

-tit te tyre ne kapitalin themeltar.

Ortakët e Shoqerise pergjigjen vetem per detyrimet e saj. Pjesemarrja ne Shoqeri nuk i pengon ata qe te kene pavaresi ligjore dhe te drejta pronesije jashte saj. Ata nuk pergjigjen per detyrimet e njeri tjetrit nga veprimtari te tjera.

Neni 9

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore mbi 10 vjet. Ajo mund te likuidohet ne marreveshje ndermjet ortakeve apo sipas dispozitave ne fuqi.

Neni 10

Organizimi dhe administrimi i Shoqerise percaktohen hollesisht ne Statutin e Shoqerise qe eshte pjese e pandare e ketij Akti.

Neni 11

Ky Akt Themelimi hartohet dhe firmoset me vullnetin e lire te Ortakeve, ne kater kopje, njera prej te cilave qendron ne dokumentacionin baze te Shoqerise. Te kater kopjet kane vlere te barabarte ligjore.

O R T A K E T

SPARTAK HAXHIU



NAZMI BAKO



S T A T U T



I SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI
TE KUFIZUAR " TERMO MONT " SH.P.K

Themeluesit qe firmosin me poshte :

SPARTAK HAXHIU , i biri i Ksenofonit, i datelindjes 1952, lindur ne Gjirokaster, banues ne Tirane, Rr. 'Ali Baushi', Pall.7, Shk.1, Ap.3, me numur pasaporte 484731 ,

NAZMI CAKO , i biri i Qemalit, i datelindjes 1952, lindur ne Kolonje, banues ne Tirane, me numur pasaporte AZ 034208 ,

qe ne vijim do te quben 'ortake' ,

sot me date 22.05.1997 , bazuar ne vullnetin e tyre te lire, ne per-
-puthje me Ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" dhe Aktin e Themelimit, kane hartuar Statutin e Shoqerise, si me poshte vijon :

KREJ I

RREGJIMI JURIDIK, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIJA, KOHEZGJATJA

Neni 1

Forma e Shoqerise : 'Shoqeri Tregetare me Pergjegjesi te Kufizuar'.
Veprimtaria e saj i neneshtrohet dispozitave te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 'Per Shoqerite Tregetare', si dhe dispozitave te Aktit te Themelimit e ketij Statuti, dhe te gjitha dispozitave ligjore ne fu-
-qi ne Republikën e Shqiperise.

Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregetar nga Organet Kompetente dhe ne perputhje me ligjin.

Neni 2

Emertimi i Shoqerise : " TERMO MONT " SH.P.K.

Neni 3

Shoqeria ka kete objekt veprimtarie :

Ndertime civile industriale, turistike, bujqesore, etj. dhe kompletimi

me instalimet e nevojeshme per to (Punimet e montimit).

Montimi i impianteve teknologjike dhe te veçanta :

- impiante termike, te ventilimit, kondicionere, si dhe mirembajtja e riparimi i tyre
- impiante higjenosanitare, hidrosanitare, te gazit, si dhe mirembajtja e riparimi i tyre
- impiante ashensoresh, shkalle levizese, transportiere, etj., si dhe mirembajtja e riparimi i tyre

Punime hidraulike :

- ujesjellesa, kanalizime, impiante vaditese, etj.
- gazsjellesa, vajesjellesa, etj. te ketij karakteri
- impiante te pastrimit te ujit

Instalimi i impianteve dhe makinerive ngritese e transportuese, si vinça, teleferike, etj. te ketij karakteri.

Import-eksporti e tregetimi i pajisjeve, makinerive, pjeseve te kombinit materialeve te ndertimit e te llojeve te ndryshme.

Neni 4

Selija juridike e Shoqerise ndodhet ne Tirane ne adresen :

Rruga 'Ali Baushi', Pall.7, Shk.1, Ap.3

Shoqeria, me vendim te Asamblese se Ortakeve, mund te krijoje qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise.

Neni 5

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore mbi 10 vjet. Por ajo mund te likuidohet ne marreveshje ndermjet ortakeve, apo sipas dispozitave ne fuqi.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR

Neni 6

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100 000 Leke (njqindmije). Ky kapital perbehet nga kontributet e neposhteme te ortakeve :

| | |
|----------------|-------------|
| SPARTAK HAXHIU | 51 000 Leke |
| NAZMI ÇAKO | 49 000 Leke |




Perkatesisht :

| | |
|----------------|------|
| SPARTAK HAXHIU | 51 % |
| NAZMI ÇAKO | 49 % |

Neni 7

Kapitali themeltar nuk mund te rezultoje me pak se 100 000 Leke. Zvogelimi ne nje vlere me te vogel e detyron Shoqerine te shndrrohet ne nje forme tjeter, neqoftese ajo nuk merr nje vendim per rritjen e tij te pakten deri ne vleren e mesiperme. Ne rast te kundert çdo ortak ose i interesuar tjeter, mund te kerkoje ne Gjykate prishjen e saj.

Neni 8

Kapitali themeltar mund te shtohet, duke respektuar perqindjet e ortakëve ne kapital si mesiper, ose duke i ndryshuar ato me marreveshje ndermjet ortakëve.

Pjeset e kapitalit themeltar duhet te neneshkruhen ne teresine e tyre nga ortakët dhe te shlyhen krejtesisht, si per rastet kur perfaqesojne kontribute ne para, ashtu edhe per kontributet ne natyre. Ato nuk mund te perfaqesojne kontribute ne sherbime ose letra me vlere te tregetueshme.

Neni 9

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakëve.

Pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne Shoqeri, vetem me miratimin e shumices se ortakëve qe perfaqesojne te pakten 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar.

Kuota qe posedon çdo ortak ose pjese te saj nuk mund te transferohet tek te tretet, ne rast se me pare nuk i ofrohet me prioritet ortakut tjeter. Po keshtu edhe ne rastin e vdekjes se nje ortaku, trashegimtaret e ligjshem qe kane ndermend te shesin kuotat, mund ta bejne kete vetem duke ndjekur proceduren e mesiperme.

KREJU III

DREJTIMI E ADMINISTRIMI

Neni 10

Vendimet merren nga Asambleja e Ortakëve. Mbledhjen e Asamblese mund ta kerkojne nje ose disa ortakë qe disponojne te pakten 10 % te pjeseve te kapitalit themeltar. Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime dhe disponon nje numur votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar

qe ai zoteron. Ne mbledhjet e Asamblese vendimet merren nga nje ose disa ortake, qe perfaqesojne me shume se 1/2 e pjeseve te kapitalit themeltar.

Ndryshimet e Statutit vendosen nga ortaket qe perfaqesojne te pakten 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar. Sidoqofte, ne asnje rast kjo shumice nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar.



Neni 11

Shoqeria me vendim te Asamblese se Ortakeve mund te administrohet nga nje administrator ose disa administratore, qe formojne Keshillin Administrativ. Keshilli Administrativ mund tu lere kompetenca te njejta administratoreve ose mund tu caktojte kompetenca te vecanta.

Neni 12

Organi i pare administrativ caktohet ne Aktin e Themelimit te Shoqerise. Sipas atij Akti, Shoqeria "TERMO MONT" SH.P.K. do te administrohet nga dy administratore : z.SPARTAK HAXHIU dhe z.NAZMI CAKO.

Neni 13

Administratoret kryejne te gjitha veprimet e administrimit ne interes te Shoqerise. Ata kane te gjitha kompetencat per te vepruar ne maredhenie me te tretet ne emer te Shoqerise ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te kompetencave qe ligji ua jep shprehimisht ortakeve.

Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratorit edhe kur keto akte nuk perfshihen ne objektin e Shoqerise. Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e Shoqerise, ose kur te tretet nuk mund te injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e Statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Administratoret jane pergjegjes ndaj Shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te Statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit.

Neni 14

Administratori shkarkohet me vendim te ortakeve qe perfaqesojne me teper se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar. Çdo klauzole e kundert konsiderohet e pavlefshme. Ne rast se shkarkimi eshte bere pa arsye te drejta, ai le shkak per demshperblim financiar. Pervec kesaj, administratori shkarkohet nga gjykata per shkelje te ligjit me kerkese te çdonjorit prej ortakeve.

KREU IV

MAREDHENIET FINANCIARE

Neni 15

Viti financiar fillon me 1 Janar te çdo viti dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar do te filloje me regjistrimin e Shoqerise ne Regjistrin tregetar dhe do te mbaroje me 31 Dhjetor. Llogarite e Shoqerise mbahen konform dispozitave dhe normave te legjis-lacionit shqipetar.

Neni 16

Kontrolli financiar i Shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i emeruar nga Asambleja e Ortakeve per nje periudhe prej 3 vitesh financiare nga shumica e ortakeve qe zoterojne mbi 1/2 e kapitalit themeltar.

Eksperti kontabel i autorizuar garanton qe llogaritevjetore te jene te rregullta e te hartuara me sinqeritet dhe te japin nje pasqyrim besnik te rezultatit te operacioneve te vitit te kaluar financiar, si dhe te gjendjes financiare e trashegimise se Shoqerise ne fund te vitit.

Neni 17

Raporti i administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore te hartuara nga administratori, i neneshtrohen miratimit te Asamblese se Ortakeve brenda nje afati prej 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar. Dokumentat e mesiperme vihen ne dispozicion te ekspertit kontabel te autorizuar te pakten 40 dite perpara mbledhjes se Asamblese. Eksperti kontabel i autorizuar lejohet te marre pjese ne mbledhjen e Asamblese.

Neni 18

Te ardhurat neto te Shoqerise qe rezultojne nga bilanci vjetor do te shperndahen si vijon : 5 % per fondin rezerve, deri sa ky fond te arrijne ne 1/5 e kapitalit themeltar. Pjesa tjeter do ti shperndahet ortakeve ne raport me perqindjet qe ata zoterojne ne kapitalin themeltar.

KREU V

PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 19

Ne çdo kohe dhe per çdo shkak te prishjes se Shoqerise, Asambleja ven-

-dosmodalitetet e likuidimit dhe cakton nje ose disa likuidatore, duke i fiksuar dhe fuqite, te cilet i paraqesin raportin per aktivin dhe pasivin e Shoqerise, per veprimet e likuidimit si dhe periudhen e nevojshme te perfundimit.

Neni 20

fund te procesit te likuidimit Asamblea vendos me shumicen e ortakëve qe zoterojne mbi 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar, mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmerise se punes se likuiduesit dhe mbylljen e procesit te likuidimit.

Neni 21

Mbas pagimit te kreditorëve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura ndermjet ortakëve proporcionalisht me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin themeltar.

KREU VI

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 22

Mosmareveshjet qe mund te lindin ndermjet Shoqerise, ortakëve, administratorëve e likuiduesve, qe nuk mund te zgjidhen me mareveshje, do ti paraqiten per zgjidhje Gjykates kompetente shqiptare.

Neni 23

Per ate çka nuk eshte parashikuar ne kete Statut, do te behet referim ne Ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", si dhe ne legjislacionin tjeter ekzistues ne Republiken e Shqiperise.

Neni 24

Ky Statut hartohet dhe firmoset me vullnetin e lire te ortakëve ne katë kopje, njera prej te cilave qendron ne dokumentacionin baze te Shoqerise. Te gjitha kopjet kane vlere te barabarte ligjore.

O R T A K E T

SPARTAK HAXHIU



NAZMI ÇAKO



K E R K E S E

Margjorie feda

KERKUESIT : SPARTAK HAXHIU , i biri i Ksenofonit, i datelindjes 1952,
 lindur ne Gjirokastrer, banues ne Tirane, Rr. Ali Baushi,
 Pall.7, Shk.1, Ap.3, me numur pasaporte 484731
 NAZMI CAKO, i biri i Qemalit, i datelindjes 1952. 1166-
 Kolonje, banues ne

OBJEKTI : Regjistrim Shoqerie
 PER KOMPETENCE : Gjykates se R



Me anen e kesaj kerkese i kerkojme Gjykates se Rrethit Tirane, rregjis-
 -trimin e Shoqerise Tregtare "TERMO MONT" SH.P.K. si person juridik.
 Shoqeria do te kete kete objekt veprimtarie :

Ndertime civile industriale, turistike, bujqesore, etj., si dhe kompleti-
 -mi me instalimet e nevojeshme per to (punimet e montimit).

Montimi i impianteve teknologjike dhe te veçanta :

- impiante termike, te ventilimit, kondicioneret, si dhe riparimi e mirembajtja e tyre
- impiante higjenosanitare, hidrosanitare, te azit, si dhe riparimi e mirembajtja e tyre
- impiante ashensoresh, shkalle levizese, transportere, etj, si dhe riparimi e mirembajtja e tyre

*Be regjistruar
 Kullës s.
 dt. 26-5-97
 Gj. P. P. P.
 Nr. J. J. J.*

Punime hidraulike :

- ujesjellesa, kanalizime, impiante vaditese, etj.
- gazsjellesa, vajsjellesa, etj. te ketij karakteri
- impiante te pastrimit te ujit

Instalimi i impianteve dhe makinerive ngritese e transportuese, si vinça
 teleferike, etj. te ketij karakteri.

Import-eksporti e tregetimi i pajisjeve, makinerive, pjeseve te kembimit
 materialeve te ndertimit e te llojeve te ndryshme.

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100 000 Leka (njqindmije).

Selija juridike e Shoqerise ndodhet ne adresen : Rr. Ali Baushi, Pall.7,
 Shk.1, Ap.3, Tirane. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per nje
 periudhe kohore mbi 10 vjet. Administratore te saj do te jene :
 z.Spartak Haxhiu dhe z.Nazmi Cako.

Per sa mesiper, ju lutemi Juve, te urdheroni regjistrimin e Shoqerise
 Tregtare "TERMO MONT"SH.P.K. SI PERSON JURIDIK.

KERKUESIT : Spartak Haxhiu Nazmi Cako

[Signature of Spartak Haxhiu]

[Signature of Nazmi Cako]

19

17299/1

1648

K E R K E S E

Ej M. Jeta
19.01.2001
19 GEN. 2001

KERKUESIT: Spartak Haxhi i biri Ksenofonit i dtl. 1952, banues ne Tirane
Nazmi Cako i biri Qamilit i dtl. 1952, banues ne Tirane
Administrator te Shoqerise "TERMO MONT" shpk.

OBJEKTI: Kerkojme depozitim e Vendimit te Asamblese se ortakeve te
Shoqerise NR. 1 Date 13.10.2000 ne baze te Ligjit NR.7667
Date 28.01.1998

**GJYKATES SE RRETHIT
TIRANE**

*Bej alipon toke
K. Mubare
Tirane
Nr. 17299
Nr. 889 REP
all 17-12-2000*

Me Vendimin Nr.17299 date 26.05.1997 te Gjykates se Rrethit
Tirane eshte regjistruar si person juridik Shoqeria "TERMO MONT" shpk
shoqeri kjo me dy ortak dhe te dy Administratore Spartak Haxhi dhe Nazmi
Cako me kapital 100.000 leke i ndare ky kapital Spartak Haxhi 51% dhe
Nazmi Cako 49%, me seli ne Tirane.

Me vendim te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "TERMO
MONT" shpk NR.1 Date 13.10.2000 eshte vendosur:

1. Shitja e pjeseve te kuotave te kapitalit themeltar te ortakeve
Spartak Haxhi ne masen 10% dhe Nazmi Cako ne masen 10% ,
Z. Mark Kaçaj.
2. Pranimin si ortak ne kete shoqeri te Z. Mark Kaçaj me kuote 20%
te kuotave te kapitalit themeltar
3. Ndrimi i selise se shoqerise nga adresa Rruga "Ali Baushi" P.7
shk.1 ap.3, ne kete adrese Rruga "Qemal Stafa" NR.260/1.

Nga sa parashtroam me lart kerkojme depozitim e vendimit te
Asamblese se Ortakeve te shoqerise dhe keto ndryshime te pasqyrohen ne
Rregjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane.

KERKUESIT

Spartak Haxhi Nazmi Cako

Signature of Spartak Haxhi and Nazmi Cako

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 889 REP.



VERTETIM

Sot me date 17 Dhjetor 2000 (dymije) para meje Noteres u
paraqiten personalisht Spartak Haxhi i biri Ksenofonit i dtl. 1952, lindur ne
Gjirokaster, banues ne Tirane Rruga "Ali Baushi" P.7, shk.1 ap.3, per
identitetin e saj u sigurova nga pasaporta personale NR.484731, madhor,
me zotesi te plate juridike dhe per te vepruar Nazmi Cako i biri Qamilit i
dtl.1952, lindur ne kolonje, banues ne Tirane , per identitetin e tij u sigurova
nga leternjoftimi personal AZ NR.0344206, madhor, me zotesi te plate juridike
dhe per te vepruar te cilet deklaruan se kerkesa eshte sipas vullnetit te lire
dhe neneshkruan rregullisht para meje noteres dhe une noterja e vertetoj.

Notary Seal and Signature

SHOQERIA "TERMO MONT" shpk

V E N D I M i A S A M B L E S E S E O R T A K E V E

Sot me date 13.10.2000 ne Ortaket e shoqerise "TERMO MONT" shpk Spartak Haxhi dhe Nazmi Cako, shoqeri kjo e Rregjistruar si person Juridik me Vendim te Gjykates se Rrethit Tirane NR17299 Date 26.05.1997 me Seli ne Tirane, me kapital themeltar 100.000 (njqind mije) leke, i ndare ky kapital Spartak Haxhi 51% dhe Nazmi Cako 49 te kapitalit themeltar dhe te dy Administrator me objekt ne fushen e ndertimeve civile dhe industriase.

Shqyrtuam aktivitetin e shoqerise dhe kerkesen e Z. Mark Kaçaj i cili kerkon te hyje si ortak ne kete shoqeri i cili pranon te bleje kuoten ne masen 20% te kapitalit themeltar.

Ne perfundim mbas diskutimeve ne unanimitet Asamblea e Ortakateve

V E N D O S I :

1. Shitjen e pjeseve te kuotave te kapitalit themeltar te ortakëve Spartak Haxhi ne masen 10% dhe Nazmi Cako ne masen 10% , Z. Mark Kaçaj.
2. Pranimin si ortak ne kete shoqeri te Z. Mark Kaçaj me kuote 20% te kuotave te kapitalit themeltar
3. Ndrimin e selise se shoqerise nga Adresa: Rruga "Ali Baushi" P.7 shk.1 ap.3 ne adresen: Rruga "Qemal Stafa" NR.260/1.

Kerkojme qe keto ndryshime te depozitohen ne rregjistrimn Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane.

Asamblea e Ortakëve
Spartak Haxhi Nazmi Cako

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 3096 REP.

V E R T E T I M

Sot me date 20 Dhjetor.2000 (dymije) para meje Noteres u paraqiten personalisht Spartak Haxhi i biri Ksenofonit i dtl. 1952, lindur ne Gjirokaster, banues ne Tirane Rruga "Ali Baushi" P.7,shk.1 ap.3,per identitetin e saj u sigurova nga pasaporta personale NR.484731, madhor, me zotesi te plate juridike dhe per te vepruar Nazmi Cako i biri Qamilit i dtl.1952,lindur ne kolonje, banues ne Tirane , per identitetin e tij u sigurova nga leternjoftimi personal AZ NR.0344206, madhor, me zotesi te plate juridike dhe per te vepruar te cilet deklaruan se vendimi i Asamblese eshte sipas vullnetit vullnetit te lire dhe neneshkruan rregullisht para meje noteres dhe une noterja e vertetoj .



17299/2

K E R K E S E

313 Mica
09 MAJ 2005
Handwritten signature

KERKUESI : SPARTAK HAXHI , banues ne Tirane ,
NAZMI CAKO , banues ne Tirane

OBJEKTI : Kerkojme depozitim e vendimit Nr. 2 date 04.05.2005 te Asamblese Ortakve te Shopqerise " TERMO - MONT " SHPK , ne baze te Ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 " Per Rregjistrin Tregetar " .

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE

TIRANE

Handwritten signature: *Tei depozitimit*

Me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 17299 date 26.05.1997 , eshte rregjistruar si person juridik Shoqeria " TERMO MONT " SHPK me Seli ne Tirane , me tre ortakve Z. Spartak Haxhi , Nazmi Cako dhe Z. Mark Kaçaj , me kapital themellar 100.000 leke , me kohezgjatje mbi dhjete vjet .

Me vendim Nr. 2 date 04.05.2005 Asambleja e Ortakeve te Shoqerise ka shpallur vendosur : Te caktoje Zj. Violeta Haloci , eksperte kontabel e autorizuar me license Nr. 83 te hartojte raportin per rritjen e kapitalit te Shoqerise " TERMO - MONT " SHPK .

Nga sa parashtroam me lart, kerkoj depozitim e vendimit Nr. 2 date 04.05.2005 te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise " TERMO - MONT " SHPK ne Rregjistrin Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane per te bere ndryshimet perkatese .

K E R K U E S I

SPARTAK HAXHI NAZMI CAKO

Handwritten signature of Spartak Haxhi

Handwritten signature of Nazmi Cako

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 2979 Rep.

V E R T E T I M

Vertetohet se sot me date 07.05.2005 (dymije e pese) ne dhomen e Notereve ne Tirane para meje Noteres Shkendie Shahu , me Seli ne Rrugen e " Duresit " Nr. 38 , u paraqiten personalisht Z. Spartak Haxhi dhe Z. Nazmi Cako , per identitetin e te cileve u sigurova nga dokumentat e tyre personale , madhore , me zotesi te plote juridike per te vepruar , te cilet deklaruan se kerkesa drejtuar gjykates se shkalles se pare Tirane eshte nenshkruar nga yete ata dhe une noterja e vertetoj ne baze te ligjit .



NOTERE
SHKENDIE SHAHU
CEL: 069 21 44 855

Handwritten signature of Shkendie Shahu

TERMO-MONT sh.p.k
Rruga Q.Stafa 260/1 Tirane
K.Fiskal 3706894 **N.I.P.T.** J 72015003 E
Tel: +3554 345967 Tel/fax : 376528
E-mail : gtm@albaniaonline.net

Tirane 04.05.2005

V E N D I M Nr.2

Shoqeria TERMO-MONT sh.p.k. eshte regjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr.17299 dt.26.05.1997, ndryshuar me Vendimin Nr.17299/1 dt.22.012001

Asambleja e ortakeve e shoqerise TERMO-MONT sh.p.k , e perbere nga: Spartak HAXHI , Nazmi CAKO dhe Mark KAÇAJ , e mbledhur sot me dt. 04.05.2005

V E N D O S I :

Te autorizojë Zj.Violeta HALOCI, eksperte kontabel e autorizuar me license Nr.83, te hartojë raportin per rritjen e kapitalit te nenshkruar te shoqerise sone.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Spartak HAXHI
TERMO MONT Shpk
MONTIM IMPORT EXPORT
TIRANË ALBANIA

Nazmi CAKO

Mark KAÇAJ

19299/3

16 M B Mucos
1200000000
Haxhi

K E R K E S E

KERKUESI : . z. SPARTAK HAXHI, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e administratorit te shoqerise "TERMO MONT" sh.p.k

Objekti : Depozitimim ne regjistrin tregtar te vendimit nr 3, date 16.05.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "TERMO MONT" sh.p.k

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TIRANE

Me vendimin nr. 19299, dt. 26.05.1997 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare "TERMO MONT" sh.p.k me ortak Spartak Haxhi dhe Nazmi Cako dhe administrator te dy ortaket Spartak Haxhi dhe Nazmi Cako me seli ne Tirane.

Me vendimin nr.19299/1, date 22.01.2001 kjo shoqeri ka bere shtese ortaku ku futet z. Mark Kaçaj me 20 % kuota si dhe ka ndryshuar seline e shoqerise e cila tani ndodhet ne rrugen "Qemal Stafa", nr.260/1. Pra kjo shoqeri behet me tre ortake z. Spartak Haxhi, Nazmi Cako dhe Mark Kaçaj, me administrator Spartak Haxhi dhe Nazmi Cako.

Me vendimin nr.2 te Asamblese se Ortakeve ta dates 04.05.2005 kjo shoqeri ka vendosur te caktoje si eksperte kontabel te autorizuar Violeta Haloci me license nr.83 te hartoje raportin per rritjen e kapitalit te nenshkruar te shoqerise .

Me vendimin nr.3 te Asamblese se Ortakeve date 16.05.2005 eshte vendosur:

1. Te miratoje raportin e rritjes se kapitalit te nenshkruar te shoqerise "TERMO MONT" shpk te vleresuar nga ekspertja kontabel e autorizuar znj. Violeta Haloci , e cila nga 100.000 leke behet ne 29.711.000 leke.
2. Depozitimim e ketyre ndryshimeve ne regjistrin tregtar.

Ne keto kushte kerkoj depozitimim e ketyre ndryshimeve prane regjistrin tregtar.


K E R K U E S I
SPARTAK HAXHI

DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 3240 REP.

Handwritten notes and signatures:
"Kjo shoqeri te het ketere 16.5.05"
"Rreptet Nr 5 dt 16.05.05"
"As Ortakeve"
"Raport Ekspert"
"Bilanci Defan"

VERTETIM

Sot me date 16.05.2005, para meje noterit publik Shkendie Shahu, me seli ne Tirane, u paraqit personalisht z.SPARTAK HAXHI, shtetas shqiptar, i identifikuar prej meje nepermjet ; madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e administratorit te shoqerise "TERMO MONT" sh.p.k, i cili me deklaroi se dokumentin e mesiperm e ka redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkruan ate para meje. Une noterit e vertetoj ate sipas ligjit.



TERMO-MONT sh.p.k
Rruga Q.Stafa 260/1 Tirane
K.Fiskal 3706894 **N.I.P.T.** J 72015003 E
Tel: +3554 345967 Tel/fax : 376528
E-mail : gtm@albaniaonline.net

Tirane *16/05/2005*

V E N D I M Nr.3

Shoqeria TERMO-MONT sh.p.k. eshte regjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr.17299 dt.26.05.1997, ndryshuar me Vendimin Nr.17299/1 dt.22.012001

Asambleja e ortakeve e shoqerise TERMO-MONT sh.p.k , e perbere nga: Spartak HAXHI , Nazmi CAKO dhe Mark KAÇAJ , e mbledhur sot me dt. *16/05/2005*

V E N D O S I :

Te rrise kapitalin e nenshkruar te shoqerise nga 100.000 leke, ne 29.711.000 leke, duke perdorur per kete qellim Fitimin e Mbartur deri me 31.12.2003 reflektuar ne Bilancin Financiar per vitin ushtrimor 2004 mbyllur me 31.12.2004

Ky vendim bazohet ne :

1. Ligjin 7638 dt.19.01.1992 "Per Shoqerite Tregetare
2. Raportin e Ekspertes Kontabel te Autorizuar.

Ekspertja kontabel e autorizuar (Violeta HALOCI) eshte miratuar per hartimin e ketij raporti nga gjykata e Rrethit Tirane me Vendimin

Nr *19299/2* dt *09/05/2005*

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Spartak HAXHI
TERMO MONT Shpk
MONTIM IMPORT EXPORT
TIRANE ALBANIA

Nazmi CAKO

Mark KAÇAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR. 3242

PULLE TAKSE



VERTETIM

Sot me date 16 05.2005, para meje noterit publik Afrodhiti Gjebero, me seli ne Tirane, u paraqit personalisht z.Violeta Haloci, shtetase shqiptar, i identifikuar prej meje nepermjet ; madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, e cila me deklaroi se dokumentin e mesiperm e ka redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkruan ate para meje. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

